



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.1035/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti ne çështjen juridike përmbarimore të Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Viva Fresh” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810670390 dhe seli në Prishtinë, përfaqësuar nga zyra ligjore “Pro Juris”, me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2649/22 të datës 29.05.2023, me datën 14.02.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e debitorit “Viva Fresh” Sh.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2649/22 të datës 29.05.2023, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2649/22 të datës 29.05.2023, e ka refuzuar si të pabazuar në tërësi prapësimin e debitorit “Viva Fresh” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810670390, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr.211/22, i lejuar me datë 07.12.2022, nga Përmbaruesi Privat Driton Govori.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktvendimin e shkallës së parë ta ndryshoj ashtu që urdhri përbarimor të shfuqizohet në tërësi ose aktvendimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në shkallë të parë në rivendosje .

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), gjeti se:

**-Ankesa e debitorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 07.12.2022 ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përbarimor - Vendimit Nr. 06-97-2/2021, të datës 28.12.2021, i lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës.

Përbaruesi Privat Driton Govori nga Prishtina, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përbarimor P.nr.211/22, i lejuar me datë 07.12.2022, ka lejuar përbarimin, me të cilin detyrohet debitori që në emër të masës ndëshkimore - gjobës, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 10.000 euro, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor dhe ka theksuar se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk është i përshtatshëm për përbarim, dhe se ndaj të njëjtit debitori ka iniciuar konfliktin administrativ së bashku me kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të aktit administrativ dhe se paraqitja e padisë e bën vendimin mbi bazën e të cili është lejuar urdhri të pa-përbarueshëm. Gjykatës, i ka propozuar që ta aprovoj si të bazuar prapësimi, ta anuloj urdhrin përbarimor dhe ta obligoj kreditorin që të bartë shpenzimet e procedurës përbarimor.

Kreditori, në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit dhe ka theksuar se paraqitja e padisë në konflikt administrativ nuk e shtynë ekzekutimin e vendimit. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar dhe urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.2649/22 të datës 29.05.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar në tërësi prapësimin e debitorit “Viva Fresh” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810670390, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr.211/22, i lejuar me datë 07.12.2022, nga Përmbaruesi Privat Driton Govori.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se Vendimi Nr. 06-97-2/2021, i datës 28.12.2021, i lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës, është bërë i plotfuqishëm dhe mban vulën e ekzekutueshmërisë së datës 10.10.2022, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36, paragrafin 1 të LPP-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrit të përmbaruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori. Kjo gjykatë vlerëson se vendimi Nr. 06-97-2/2021, të datës 28.12.2021, i lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës, është dokument përmbarues dhe i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: “ *Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (me tej: ujdia)*” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 sepse, po ashtu është në pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 të LPP i cili përcakton se: “*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”, ndërsa një dokument përmbarimor për të shërbyer si titull përmbarues patjetër duhet të përmbajë elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbarimor. Në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të

plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbarimor të papërshtatshëm për përmbarim.

Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se Nr. 06-97-2/2021, të datës 28.12.2021, i lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës, është dokument i përmbarueshëm dhe i cili vendim është i plotfuqishëm dhe është i ekzekutueshëm nga data 10.10.2022, ashtu qe si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e detyrimit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “ *Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri* ”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “ *Vërtetimin për përmbarueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë* ”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbarim. Arsye këto nga te cilat edhe kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e debitorit janë te paargumentuara dhe si te tilla mbeten vetëm ne natyrën deklarative , te pambështetura ne prova ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 te LPP.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,

Dhoma e Shkalles se Dytë

K.DH.SH.II nr.1035/23, me datë 14.02.2024

Gjyqtarja

Saranda Bogaj Sheremeti